

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “C.P.” sh.p.k. –T. për D. e C. R., të cilën e përfaqëson me autorizim S. K., avokat nga ..., kundër të paditurës Republika e Kosovës-Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilire Eydogan, avokate publike, për shkak të pasurimit të pabazë, në shumë të përgjithshme prej 20.880 €, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.269/17 datë 2.4.2019 në seancën e kolegjit të mbajtur më 12.6.2019, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

APROVOHET revizioni i të paditurës dhe **ndryshohen** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.269/17 datë 2.4.2019, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike I.C.nr.342/15 datë 18.10.2017, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “C. P.” sh.p.k. –T. për D. e C. R., që të detyrohet e paditura Republika e Kosovës-Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve, me seli në Prishtinë, që në emër të pasurimit të pabazë juridike, t’ia paguaj shumën prej 20.880 €, me kamatë të njëjtë, siç e aplikojnë bankat të cilat operojnë në Kosovë, me rastin e deponimit të mjeteve në bankë, në afatin prej 1 viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë më 11.8.2015, e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.269/17 datë 2.4.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike I.C.nr.342/15 datë 18.10.2017, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “C. P.” sh.p.k. –T. për

C. e C. R., dhe është detyruar e paditura Republika e Kosovës-Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve, me seli në Prishtinë që në emër të pasurimit të pabazë juridike, paditësit t'ia paguaj shumën prej 20.880 €, me kamatë të njëjtë, siç e aplikojnë bankat të cilat operojnë në Kosovë, me rastin e deponimit të mjeteve në bankë, në afatin prej 1 viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë më 11.8.2015, e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 853,20 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK-së, dhe gjeti se:

Revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi për marrjen e lejes për ndërtimit të objektit afarist ka aplikuar tek Ministria e Transportit dhe Post - Telekomunikacionit për marrjen e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirës rrugore – brezit rrugor, në rrugën magjistrale M25, drejtimi Prizren – Prishtinë. Komisioni i formuar i të paditurës ka konstatuar se sipërfaqja e tokës publike të cilën do ta shfrytëzojë paditësi është 780 m2. Më datë 3.7.2007, paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës publike, në sipërfaqen prej 780 m2, ndërsa paditësi ka marrë obligim që për shfrytëzimin e kësaj hapësire të paditurës t'ia paguaj shumën prej nga 6.240 €, në vit. Më datë 21.10.2014, paditësi pran të paditurës ka paraqitur kërkesë për ri matjen e sipërfaqes kontestuese, ndërsa e paditura me vendimin nr. 01-445 datë 10.2.2015 ka aprovuar kërkesën e paditësit dhe ka ndryshuar sipërfaqen e shfrytëzimit nga 780 m2 në 380 m2, duke obliguar Drejtorin e Rrugëve të ndryshojë kontratën dhe llogaritja të bëhet në bazë të sipërfaqes së konstatuar nga komisioni i cili ka bërë verifikimin e sipërfaqes dhe tarifën e caktuar nga Ministria e Infrastrukturës. Më datë 19.2.2015 e paditura dhe paditësi kanë lidhur kontratën nr.201 për shfrytëzimin e brezit rrugor, ndërsa duke marrë për bazë vendimin e cekur, kanë obliguar paditësin që për sipërfaqen prej 380 m2, për çdo vit të paditurës t'ia paguaj shumën prej 1520 €, nga data e lëshuarjes së pëlqimit. Paditësi nga viti 2007 deri në vitin 2013 të paditurës

për çdo vit në emër të shfrytëzimit të aksit rrugor në sipërfaqe prej 780 m<sup>2</sup>, i ka paguar shumën prej nga 6.240 €.

Paditësi me padi ka kërkuar që si rezultat i gabimit në matje nga komisioni i të paditurës, i njëjti është varfëruar pa bazë juridike dhe ka kërkuar që të obligohet e paditura në emër të pasurimit të pabazë t'ia kthej shumën prej 20.880 €, me kamatë të precizuar si në petitumin e padisë.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe duke aplikuar dispozitën e nenit 210 të LMD –ës ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka vlerësuar si të drejt e të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse gabimi në matjen e sipërfaqes publike të cilën e ka shfrytëzuar paditësi është bërë nga komisioni i formuar nga Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit, dhe sipërfaqja prej 780 m<sup>2</sup> për të cilën paditësi e ka paguar çmimin e shfrytëzimit, rezulton se ka qenë 380 m<sup>2</sup>, e me këtë ka ndryshuar edhe çmimi i përgjithshëm nga 6240 € në 3.040 € në vit, pastaj ankesën e të paditurës e ka vlerësuar si të pabazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e vërtetuar faktike, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, mbi gjendjen e tillë të vërtetuar faktike, gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur të dy gjykatat e instancës më të ulët kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Kjo ngase, fitimi pa bazë mund të ekzistojë kur prej një subjekti në subjektin tjetër pasuria kalon pa bazë juridike. Për të ekzistuar pasurimi pa bazë ( *conditio sine causa*) duhet të plotësohen këto kushte: të shkaktohet pasurimi i personit tjetër, pasurimi të jetë pa bazë, pasurimi të jetë në llogari të tjetrit dhe me këtë të shkaktohet varfërimi i tjetrit. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë komulative. Në rastin konkret e paditura të hollat i ka marrë në bazë të kontratës së datës nr.276 datë 3.7.2007 e cila kontratë nuk është kontestuar nga paditësi, por i njëjti ka bërë pagesën e shumës prej 6.240 €, nga viti 2007 deri në vitin 2013, andaj nuk mund të konstatohet se e paditura është pasuruar pa bazë ligjore. E paditura nga ana e saj ka përmbushur kushtet e cekura në kontratën nr.276 datë 3.7.2007, duke ia vënë në disponim sipërfaqen e aksit rrugor, ndërsa paditësi gjithashtu çmimin e ka paguar në bazë të nenit II të kontratës. Paditësi gjykatës nuk i ka ofruar provë se ka kundërshtuar sipërfaqen e as çmimin për shfrytëzimin e aksit

rrugor e përcaktuar në kontratën për shfrytëzimin e brezit rrugor dhe nuk ka provë se ka kundërshtuar faturat e të paditurës për pagesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar e vlerësoi si të bazuar, ashtu që dy aktgjykimet e gjykatave më të ulëta u ndryshuan dhe kërkesëpadia e paditësit u refuzua si e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin konkret mungon kushti i paraparë në dispozitën ligjore të nenit 210 të LMD-ës, që pasurimi të jetë pa bazë ligjore, sepse kontrata nr, 276 datë 3.7.2007 gjatë periudhës për të cilën paditësi e kërkon fitimin e humbur, ka pas efekt juridik dhe nuk është kërkuar anulimi apo ndryshimi i kushteve të kontratës. Paditësi ka pas mundësi që nga fillimi të bënë kërkesë për ndryshimin e sipërfaqes së aksit rrugor të cilën e ka shfrytëzuar dhe të kundërshton faturat e dërguara nga e paditura, por një veprim të tillë e ka ndërmarrë më 21.10.2014, të cilën kërkesë e paditura e ka aprovuar si të bazuar dhe me kontratën e datës 19.2.2015 ka ndryshuar kushtet e kontratës dhe ka caktuar sipërfaqen prej 380 m2 duke përcaktuar shumën për pagesë sipas nenit II të kontratës.

Nga fakti se e paditura nuk ka paraqitur kërkesë për pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore, gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës, konform nenit 463 par.1 të LPK-ës.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 224 par. 1 të LPK –ës, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.33 /2019 datë 12.6.2019

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku